



"për një Shqipëri më të mirë"

"për bashkimin e vërtetë të kombit"

"për mbarëvajtjen e atdheut"



PËRSHËNDETJA E PARTISË KOMUNISTE REVOLUCIONARE TURKE PARAQITUR NGA SHOKU MEHMET OZER

Të dashur shokë,

Ne jemi sot këtu, me ju, për të përkujtuar e festuar 100 vjetorin e lindjes së shokut Enver Hoxha. Ai ishte një mbrojtës i vendosur e i palëkundur i socializmit proletar, lider i lëvizjes komuniste ndërkombëtare dhe i luftës kundër revizionizmit, një mik i madh i popujve të shtypur dhe arkitekt i revolucionit e i ndërtimit socialist të Shqipërisë.

23 vjet nga ndarja fizike me të ne duhet të flasim për luftën e tij për ndërtimin e socializmit në Shqipëri dhe ndihmën për lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Nuk është nevoja t'i bëjmë komplimente por është e nevojshme t'ia prezantojmë atë brezave që vijnë sepse, lufta e tij kundër gjithë llojeve të revizionizmit (hrushovizmit, titizmit, evrokomunizmit dhe maoizmit), rezistenca e tij në mbrojtje të marksizëm-leninizmit dhe vlerësimet e tij mbi strategjitë imperialiste të Bashkimit Sovjetik, kanë rëndësi të madhe.

Është e qartë se kjo rezistencë e madhe dhe e fuqishme u mbështet në mbrojtjen e karakterit proletar të marksizëm-leninizmit, duke e zbatuar dhe zhvilluar atë mbi bazën e analizës së kushteve konkrete në tërësi dhe të çdo vendi, në veçanti.

Shoku Enver Hoxha i spjegoi shkaqet e goditjes së këtyre rrymave kundërrevolucionare dhe borgjezisë imperialiste mbi marksizëm-leninizmin dhe rëndësinë e mbrojtjes si më poshtë:

“Nuk është rastësi që imperislistët, borgjezia dhe revizionistët kanë drejtuar majën e shigjetës së tyre mbi doktrinën fitimtare marksiste-leniniste. Pa marksizëm-leninizëm nuk mund të ketë socializëm të vërtetë”. (Kong. VIII-të i PPSH-së)

Me këtë këndvështrim të qartë shoku Enver Hoxha e konsideroi mbrojtjen e M-L si gur themelor për të gjitha fitoret dhe sukseset e popullit: “Besnikëria e pakufishme e Partisë tonë në doktrinën e pavdekshme të Marksit, Engelsit, Leninit dhe Stalinit, aftësia e saj për ta zbatuar këtë doktrinë në mënyrë krijuese, në përputhje me kushtet e vendit dhe situatat e komplikuar ndërkombëtare, vendosmëria e saj për të mbrojtur pastërtinë e parimeve të kësaj doktrine nga goditjet dhe shtrembërimet e shumë armiqve të brendshëm e të jashtëm, ka qenë dhe është kushti themelor i gjithë sukseseve dhe fitoreve të popullit tonë”. (po aty)

KUNDËR ARMIQVE TË BRENDËSHË E TË JASHTËM

Kush ishin pra, “goditjet dhe shtrembërimet e armiqve të jashtëm e të brendshëm”? Goditja më e madhe ndaj luftës së Enverit për ndërtimin e socializmit në Shqipëri erdhi nga hrushovianët. Në fillim ata drejtuan goditjet e



tyre kundër Stalinit. Kjo ndodhi sepse imperialistët dhe revisionistët e dinin mirë që emri dhe vepra e Stalinit ishin të lidhura pazgjidhshmërisht me ndërtimin e socializmit në Bashkimin Sovjetik. Ata e dinin gjithashtu se nëse sulmi reaksionar do të drejtohej në sukseset e socializmit, ndërtimit të cilit Stalini i kushtoi gjithë jetën e tij, goditja do të ishte fatale dhe shkatërrimtare, duke goditur kështu rëndë shpresën dhe ëndrrën e qindra miliona njerëzve, punëtorëve e proletarëve për të ndërtuar një shoqëri pa klasa e shfrytëzim. Duke e ditur këtë fakt hrushovianët e drejtuan goditjen e tyre kundër teorisë dhe praktikës së ndërtimit socialist që ishte identifikuar me emrin e Stalinit. Këtë rrugë e vazhduan edhe pasardhësit e tyre. Se ç'ndodhi më vonë me Bashkimin e Lavdishëm Sovjetik, dihet mirë. Asnjë komunist apo simpatizant i revolucionit, duke vlerësuar atë që po ndodh sot, nuk e vë aspak në dyshim se tradhtia revizioniste dhe sulmi imperialist nuk synonte Stalinin, i cili tashmë nuk jetonte më. Përkundrazi, ato u shtrinë në një larje hesapesh totale, duke marrë revanshin mbi socializmin dhe historinë e tij.

Evrokomunistët, më vonë u shndërruan në antileninistët më të egër. Evrokomunistët, në rrugën e Hrushovit, dëshironin, siç deklaronte shoku Enver Hoxha, të shkatërronin teorinë dhe praktikën e revolucionit proletar, duke sulmuar Leninin. Titistët dhe Maoistët sulmuan parimet themelore të M-L. Ata tradhtuan klasën punëtore ndërkombëtare dhe popujt e botës, duke gjetur strehë në retorikën boshe.

LIDER I LUFTËS KUNDËR REVIZIONIZMIT

Të vlerësosh Enver Hoxhën vetëm për atë që bëri në Shqipëri do të thotë të mos shohësh apo kuptosh kontributin dhe përpjekjet e tij në mbrojtjen dhe zhvillimin e doktrinës shkencore të klasës punëtore ndërkombëtare, rolin i tij në ballë të luftës antirevizioniste dhe mbështetjen morale që ai i dha popujve të botës, për emancipimin e tyre kombëtar dhe shoqëror. Duhet theksuar gjithashtu që Enver Hoxha, më shumë se sa për atë ç'ka bëri në vendin e tij, duhet të mbrohet dhe të kujtohet, në radhë të parë, për kontributin që dha për kauzën e madhe të klasës punëtore ndërkombëtare.

Ja përse lufta e shokut Enver Hoxha kundër revizionizmit modern dhe rrymave të ndryshme të tij, bashkë me PPSH-në nën udhëheqjen e tij, përpjekjet e mëdha për të mbrojtur marksizëm-leninizmin, rezistenca e tij kundër rrethimit nga sistemi imperialisto-kapitalist dhe përpjekjet e tij për shkatërrimin e socializmit, si dhe analizat ku zbulohen strategjitë dhe tendencat bashkëkohore të imperializmit ndërkombëtar dhe të superfuqive, kanë një rëndësi shumë të madhe sesa sukseset e tij në ndërtimin dhe mbrojtjen e socializmit në Shqipëri.

Gjithë komunistët e kujtojnë mirë se si bolshevizmi, i udhëhequr nga Lenini, mbrojtë dhe zhvilloi marksizmin, bazuar në çështjet teorike dhe koherente, kundër oportunitizmit dhe oportunistët të Internacionales së Dytë, që degjeneruan dhe braktisën traditat e tyre revolucionare. Ata kujtojnë, gjithashtu, se kjo mbrojtje përfshinte çështje të mëdha, të përfshira në polemikë, si teoria marksiste mbi shtetin, mbi doktrinën e revolucionit, mbi imperializmin dhe luftërat imperialiste, mbi organizimin e partive komuniste të tipit të ri, demaskimin e ëndrrave për



demokracinë borgjeze kritikën e ekzaltimit ndaj saj, mbrojtjen e marksizmit në ndërtimin socialist, çështje këto që ishin mbajtur të mbyllura nga udhëheqja e Internacionales së Dytë. Lenini denoncoi dëmin e madh të shkaktuar nga oportunizmi i Internacionales së Dytë, si më poshtë:

“Ajo që është e nevojshme sot është të kërkojmë të rigjejmë marksizmin, pastërtia e të cilit nuk është përdhosur dhe ta fusim atë në ndërgjegjen e masave të gjëra”. (Shteti dhe revolucioni)

Asnjë komunist i formuar nuk mund të mohojë faktin që Enver Hoxha, lideri i PPSH, luftoi njëlloj, si kundër revizionizmit të të gjitha ngjyrave. Sot ne mund të shohim e të vlerësojmë më mirë gjendjen e rëndë dhe pasojat e shkaktuara nga hrushovianët, titistët, maoistët, evrokomunistët dhe rrymat e tjera revizioniste në rrugën e revolucionit.

Në luftën kundër rrymave revisioniste shoku Enver Hoxha nu bëri vetëm mbrojtjen e tezave themelore të m-l, si ato që përmendëm më lart, por, ai i pasuroi ato në përputhje me faktet aktuale, mbrojtje gjithashtu fort materializmin filosofik. Ai denoncoi përpjekjet maoiste për ta vënë materializmin dialektik në shërbim të revizionizmit maoist, duke e shtrembëruar atë në të njëjtën mënyrë sikurse dhe tezat e tjera të m-l dhe duke e kthyer atë, në thelb, në metafizikë, në shërbim të zbulimit të rrugës që kishte marrë Kina.

Me një bindje të sigurtë të padiskutueshme ne mund të pretendojmë që ashtu sikundër Lenini ishte lideri i periudhës së shpëtimit të Internacionales së Dytë nga oportunizmi, duke realizuar revolucionin socialist dhe duke bërë marksizmin të qëndrojnë më fort në këmbët e tij, sikurse Stalini është lideri i periudhës së realizimit të ndërtimit socialist dhe i luftës kundër trockizmit, deviatorëve të tjerë dhe rrethimit imperialist, Enver Hoxha është lideri i periudhës së luftës së ftohtë kundër kthimit mbrapa dhe kundër revizionizmit modern e në pushtet.

Nëqoftëse lëvizja komuniste ndërkombëtare ka nisur të qëndrojë përsëri mbi këmbët e saj, kjo është arritur duke u mbështetur në trashëgiminë dhe platformën me të cilën Enver Hoxha luajti një rol udhëheqës duke e ndërtuar dhe transmetuar atë tek gjenerata pasardhëse. Kjo gjeneratë i ka borxh atij mbijetesën dhe platformën e tij ideologjike, e cila duhet të pasurohet sot, që t'i përgjigjet kushteve konkrete në çdo aspekt, por në pjesën më të madhe, sipas mësimëve të Enver Hoxhës.

Enver Hoxha nuk evidentoi duke përsëritur thjesht faktin që natyra e imperializmit nuk ka ndryshuar dhe që epoka jonë është epoka e imperializmit dhe e revolucioneve proletare, siç kishte thënë Lenini në fillim të shekullit të 20-të por, ai e mbrojtje dhe zhvilloi këtë teori mbi bazën e zhvillimeve konkrete, si më poshtë:

“Përqëndrimi dhe centralizimi i prodhimit dhe kapitalit, duke krijuar monopole gjigande që nuk kanë lidhje teknologjike brenda tyre, është sot shumë i përhapur. Ndërmarrjet dhe gjithë degët e prodhimit industrial, ndërtimit, transportit, tregëtisë, shërbimeve, infrastrukturës, etj, veprojnë brenda këtyre “konglomerateve gjigande”, brenda këtyre monopoleve. Ato prodhojnë gjithçka, nga lodrat e fëmijëve tek raketat ndërkontinentale!



Bashkimi dhe bashkëveprimi i ndërmarrjeve industriale, tregëtare, bujqësore dhe bankare, çojnë në krijimin e formave të reja të monopoleve, në krijimin e korporatave të mëdha industrialo-tregtare ose industrialo-bujqësore, forma që janë duke gjetur zbatim të gjërë jo vetëm në vendet kapitaliste të perëndimit por dhe në Bashkimin Sovjetik, Çekoslovakia, Jugosllavi dhe vendet e tjera revizioniste. Në të shkuarën, monopolet kombinonin magazinimin, transportin dhe shitjen e mallrave, me ndihmën e firmave të tjera të pavarura, ndërsa sot, monopolet kontrollojnë prodhimin, transportin dhe marketingun”.

Gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij, shoku Enver Hoxha ka qenë një udhërrëfyes i qartë për partitë komuniste të vendeve të ndryshme, duke përfshirë lëvizjen komuniste ndërkombëtare. Ai gjithmonë i ka inkurajuar dhe i ka dhënë atyre mbështetje morale, për të mos u ndjerë pa shpresë përballë vështirësive dhe dështimeve të kohës, por, për të ripërtërirë vehten dhe për të përcaktuar objektivat si parti luftarake. Ai e vlerësonte veprimtarinë revolucionare që bënin partitë dhe lëvizja m-l, megjithëse ajo ishte e vogël për momentin dhe i inkurajonte ato për t’u motivuar dhe për të marrë inisiativën për punë më të mëdha.

Enver Hoxha shkruante si më poshtë me një vetëbesim dhe vendosmëri të madhe:

“Partitë m-l, të gjithë revolucionarët, megjithëse të paktë në numër, duhet të futen mes njerëzve, t’i organizojnë sistematikisht masat, me kujdes dhe durim të madh, t’i bindin ato se janë forcë e madhe, që janë të afta të përmbysin kapitalin, të marrin pushtetin, ta përdorin atë në interes të proletariatit dhe të popullit. Parti të tilla nuk mendojnë që duke qenë të vogla, nuk mund të përballojnë koalicionin e partive të borgjezisë dhe opinionin e formuar prej tyre”. (Imperializmi dhe Revolucioni)

Ky pozicionim revolucionar ishte orientimi kryesor për Enver Hoxhën dhe Partinë e tij në ditët e tyre më të vështira. Bile më 1966, në mënyrë të prerë ai thoshte:

“Partia jonë beson se situata e sotme nuk lejon askend ta quajë veten komunist ose revolucionar duke ndenjtur në pritje të goditjeve të revizionistëve, duke i ndjekur ato nga larg dhe duke e kënaqur me përgëzimet për luftën kundër revizionizmit që bëjnë të tjerët. Koha nuk pret. Markistë-leninistët duhet të jenë kurdoherë në sulm, jo në mbrojtje. Ata nuk kanë pasur kurrë frikën e sulmeve dhe kërcënimeve revizioniste. Ata që tremben nga imperializmi janë revizionistët. Duke u trembur nga revizionizmi do të thotë se trembemi më shumë nga imperializmi dhe nuk kemi besim në forcën dhe fitoren e m-l”.

(Kundër revizionizmit modern)

Ky ishte pozicioni i Enver Hoxhës gjatë gjithë jetës dhe veprimtarisë së tij. Siç mund ta shoh qart kushdo në këtë citim, pozicioni i tij kundër imperializmit dhe forcave rekasionare ishte sulmi frontal. Ai nuk e zgjodhi këtë pozicion mbështetur në një besim të pabazuar, pa llogaritur mirë rrethanat dhe faktorët favorizues dhe inkurajues. Përkundrazi, ai evidentonte ku ishin mundësitë reale të revolucionit dhe të revolucionarëve. Është kjo arsyeja që ai vlerësonte shumë veprimtarinë e



përditëshme praktike dhe çdo hap e sukses të vogël të partive komuniste, veçanërisht në vendet kapitaliste imperialiste dhe i inkurajonte ato të ecin më tej në rrugën e tyre:

“Partitë e vërteta m-l qëndrojnë në pararojë dhe jo në bisht të veprimeve revolucionare. Mundësitë, përkohësisht të kufizuara të luftës dhe të përpjekjeve, nëpërmjet të cilave ato përballen me forcat e mëdha të reaksionit kapitalist, nuk duhet t’i dekurajojnë”. (Imperializmi dhe Revolucioni)

Shoku Enver Hoxha theksonte se partitë e vërteta komuniste duhet ta orientojnë vehten në drejtim të veprimtarisë së përditshme praktike revolucionare, të mësojnë bashkë me masat në këtë punë e luftë dhe që masat të fitojnë eksperiencë, bazuar në luftën e tyre. Ai gjithashtu tërhiqte vëmendjen në nevojën absolute të rëndësisë së edukimit teorik. Ai kurrë nuk e pranoi boshllëkun në teori dhe e konsideronte këtë një faktor të rëndësishëm për degjenerimin e partive të vjetra. Ai shpesh theksonte faktin që puna për studimin e m-l nuk mund të ndahet nga veprimtaria revolucionare.

Gjithë kritikrat e bëra nga Enver Hoxha dhe mbrojtja e M-L gjatë gjithë jetës së tij, nuk janë një përseritje e thjeshtë e doktrinës shkencore. Përkundrazi, kjo mbrojtje përfshinë përpjekjet dhe zhvillimin krijues të kësaj shkence mbi bazën e fakteve dhe fenomeneve aktuale. Thënë në mënyrë të thjeshtë dhe modeste, kjo është ajo që bëri Enver Hoxha dhe kontributi më i vlerë që ai dha.

Klasa punëtore ndërkombëtare dhe çdo komunist, nuk do ta harrojnë Enver Hoxhën. Ata do ta mbrojnë atë me vendosmëri, kundër gjithë sulmeve dhe do ta mbajnë lart këtë bir të madh të klasës punëtore ndërkombëtare.